12.1 - Me termin "transferim" duhet të kuptohet si përcaktohet në nenin 11.1.

12.2 - E drejta e parablerjes nuk mund të ushtrohet pjesërisht.

12.3 - E drejta e parablerjes nuk është përfshirë në transferimet pa pagesë.

12.4 - E drejta e parablerjes duhet të ushtrohet në të njëjlat kushte rënë dakord me të tretë.

12.5 - Ortaku, i cili ka për qëllim të shesë të gjitha ose një pjesë të kuotes ose opsjon të drejtave të tij për një pronar të vetëm ose një palë e tretë duhet në mënyrë preventive t'ua ofrojë ortakëve të tjerë, të cilët kanë të drejtën e parablerjes, përmes komunikimit, drejtuar nga Organi administrativ dhe ortakët e tjerë me letër rekomande me pranim. Në komunikim, ortaku duhet të tregojë kushtet e rëna dakord me ortakun apo palët e treta, në veçanti me çmimin e shitjes, kushtet e pagesës dhe të dhënat e marrësit të mundshëm. Çdo ortak i interesuar në blerjen, duke përfshirë çdo komunikim të shoqërisë blerësit të mundshëm duhet të paraqesë organit administrativ dhe transferuesit të kuotes, deklaratën e ushtrimit të parablerjes me letër rekomande me pranimin e kthimit brenda njëzet ditëve pas marrjes së komunikimit.

Organi administrativ:

a) në qoftë se e drejta e parablerjes ushtrohet nga një ortak i vetëm, vepron sipas procedurave të treguara në pikën d);

b) në qoftë se ka konkurrencë ndërmjet disa ortakëve, secili prej tyre njih të drejtën për të blerë për një shumë proporcionale me pjesën e tij aktuale ose kapitalin themelues, duke pasur parasysh se kjo përqindje rrit proporcionalisht pjesën e pjesëmarrjes të ortakëve që nuk kanë për qëllim për të ushtruar të drejtën e parablerjes;

c) në rast se pjesëmarrja e ofruar nuk është e ndarë proporcionalisht ndërmjet gjithë ortakëve që marrin pjesë, atribuon pjesën e pandashme për ortakun, në konkurrencë për blerjen, i cili ka pjesëmarrjen më të ulët në krahasim me ortakët e tjerë blerës;

d) brenda 15 ditëve pas skadimit të periudhës në fjalë të shpalljes së ushtrimit të së drejtës së parablerjes, i komunikon ortakut transferues të kuotës, ortakët të cilët synojnë të blejnë kuotën e pjesëmarrjes duke specifikuar specifikon, në rast se janë më shumë se një, pjesën e kuotes që do të blihet nga secili ortak.


12.6 - Paga për pjesëmarrje duhet të transferohet brenda 30 ditëve nga data në të cilën organi administrativ komunikon me ortakun transferues, duke pranuar ofertën treguar ortakut marrës.

12.7 - Nëse ortaku transferues nuk transferon kuotat ose të drejtat e zgjedhjes brenda periudhës në fjalë prej 30 ditësh, ai në rastin e transferimit vijues, duhet përsëri t'i ofrojë ato si parablerje ortakëve të tjerë.

12.8 - Nëse ortaku nuk ka ndërmend për të blerë aksionet e ofruara, në përputhje me kushtet dhe procedurat e përshkruara më lart, ortaku transferues është i lirë për të transferuar kuotën e pjesëmarrjes blerësit të treguar në njoftim brenda 30 ditëve nga data në të cilën organi administrativ ia komunikon këtë ortakut transferues, mungesa e ofertave për blerjen e pjesëmarrjes së tij nga ortakët e tjerë; në mungesë të kësaj, procedura duhet të përsëritet.

12.9 - Transferimi i ndodhur në shkelje të drejtës të parablerjes përfshin:

- jo efikasitetin kundër shoqërisë dhe ortakëve;



- blerësi, pra, nuk është regjistruar në regjistrin e ortakëve, nëse themeluar;
- blerësi nuk mund të ushtrojë ndonjë të drejtë bashkëngjitur në pronësinë e të drejtave dhe aksioneve të fituara, në veçanti, të drejtat e dividendit, të drejtat e votës dhe e drejta e shpërndarjes së aseteve të shoqërisë gjatë likuidimit të shoqërisë.

Neni 13 - Transferimi i kuotave për shkak të vdekjes

13.1 - Pjesëmarrjet e akteve janë lirish të transferueshme me trashëgimi për shkak të vdekjes. Nëse ka disa trashëgimtarë të ortakut të vdekur, ata duhet të caktojnë një përlaguesues të përbashkët për të vazhduar shoqërinë me ortakët e mbijetuar dhe në përputhje me nenet. 1105 dhe 1106 kodin tregtar.

Neni 14 - Pengu, uzufrukti dhe sekuestrimi i pjesëmarrjes

14.1 - Paga për pjesëmarrje nuk mund të jepet si siguri, përveç në vijim: Vendimi i ortakëve që do të merret me konsensus me shkrim nga ortakët që përfaqësojnë të paktën shtatëdhjetë për qind (70%) të kapitalit themelues. Sipas miratimit të sipërpërmendur nga ortakët, nëse titulli nuk disponon ndryshe, kreditori i siguruar ka të drejtën e votës dhe të drejtën për fitime, ndërsa i perket ortakut e drejta e zgjedhjes dhe atij i jepen aksionet regjistruar në bazë të kësaj.

14.2 - Në rast të formimit të uzufruktit, ose në favor të ortakëve të tjerë në favor të palëve të treta, aksione ose pjesë të tyre, të kufizuara në situata në të cilat e drejta për të votuar i është dhënë uzufruktarit, operon në emër të ortakëve të tjerë e drejta e parablerjes përmendur në nenin 12, me modalitetet e njëjta, kushtet dhe kulizimet e parashikuara në të. Në rast të ushtrimit të së drejtës së parablerjes, çmimi i specifikuar në ofertë ose në përcaktim do të vendoset;

- Në rast të një uzufrukti të jetës në favor të personave fizikë: duke shumëzuar çmimin e raportuar në pronësi të plotë të pjesëmarrjes për koeficientët që kanë të bëjnë me moshën e uzufruktit në fuqi në datën e transferimit, vendosur për llogaritje takse regjistrimi;

- në rastin e uzufruktit në favor të organeve, shoqërive ose personave juridikë: duke shumëzuar tatimin për pronën, apo ato të pretenduar të vendosur për kategori të krahasueshme të mallrave, në një rast tjetër, për kohëzgjatjen e të drejtës.

14.3 - Çdo krijim i uzufruktit ose një premtim i aksioneve bëre në kundërshtim me rregullat e parashikuara në këtë nen do të jetë i paefektshëm kundër shoqërisë dhe për këtë arsye organi administrativ duhet të refuzojë regjistrimin në regjistrin e aksioneve, në qoftë se është krijuar.

14.4 - Në rast të konfiskimit të pjesëmarrjes e drejta e votimit ushtrohet nga kujdestari.

Neni 15 - E drejta e tërheqjes

15.1 - E drejta e tërheqjes mund të ushtrohet në rastet e mëposhtme:
ndryshim i objektit të shoqërisë ose llojit të shoqërisë;

- shkrirje ose ndarje;

- gjendja e likuidimit revokohet;

- transferimi i zyrës së regjistruar jashtë vendit;

- përjashtim i një ose me shumë shikaqeve për tërheqjen vendosur nga memorandumit;



- çdo transaksion që mund të përfshijë një ndryshim të konsiderueshem të objektit të përcaktuar në aktin e themelimit ose një ndryshim të rëndësishëm të të drejtave të dhëna ortakëve në përputhje me nenin 2479, paragrafi i dytë, kodi tregtar;

- Zgjatja e afatit të kohëzgjatjes dhe nëse kohëzgjatja e shoqërisë bëhet me kohë të paraktuar;

- në rritjen e kapitalit të parasë me ofertë të pjesëmarrjeve ndaj palëve të treta;

- në rast të vendosjes apo heqjes së kufizimeve mbi qarkullimin e pjesëmarrjeve;

- në rastin e ndryshimeve të të drejtave të dhëna për disa ortakë lidhur me administrimin e shoqërisë apo shpërndarjen e fitimeve;

- në rastet e heqjes dorë të së drejtës së opsionit në rritjen e kapitalit bërë e nevojshme si rezultat i një rënie për humbjen dhe heqjes dore të pagesave për zgjidhjen e humbjeve të mëdha të kapitalit;

- në qoftë se ndryshon kriteri për të përcaktuar vlerën e kuotave në rast tërheqje;

- në rast të ndryshimeve të aktit të themelimit në lidhje me të drejtën e votës ose pjesëmarrje.

15.2 - Tërheqja nuk mund të ushtrohet dhe, nëse ushtrohet, është e paclokishme në qoftë se shoqëria revokon vendimin që e legjitimon ose nëse vendoset zgjidhja e shoqërisë.

15.3 - E drejta e tërheqjes ushtrohet nga ortakët të cilët nuk kanë marrë pjesë në vendimet që e përcaktojnë me kusht që:

- I kanë kaluar të paktën dy vjet nga hyrja në shoqëri;

- të jetë dhënë një njoftim prej një viti;

- Ti komunikohet Organit Administrativ, brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga vendimi që legjitimon regjistrin tregtar, me letër rekomande me pranimin e kërimit që tregon të dhënat e ortakut të tërhequr, kuoten e pjesëmarrjes për të cilën e drejta e tërheqjes ushtrohet, si dhe adresën e zgjedhur për komunikim lidhur me procedimin. Nëse fakti që legjitimon tërheqjen është i ndryshëm nga një vendim i ortakëve, e drejta e tërheqjes është ushtruar brenda tridhjetë ditëve nga njohuritë e tij nga ana e ortakut.

15.4 - Tërheqja do të fillojë nga data në të cilin letra rekomande me njohjen e marrjes është pranuar në zyrën e regjistruar të shoqërisë.

15.5 - Rimbursimi i kuotes të pjesëmarrjes, objekt tërheqje, nga shoqëria duhet të bëhet në pajtim me nenin 2473 K.C. Në rast mosmarrëveshjeje për vlerësimin e kuotes, përcaktimi i saj kryhet nga raporti i bërë i një eksperti të caktuar nga Gjykata me kërkesën e palës më diligjente.

15.6 - Rimbursimi i kuotes të pjesëmarrjes mund të bëhet:

- me blerjen e kuotes nga ortakët e tjerë, në proporcion me kuotat përkatëse të pjesëmarrjes;

- me blerjen e kuotes nga një palë e tretë, në pajtim me konsensusin e shprehur nga ortakët;

- me anë të rimbursimit të pjesës me rezervat në dispozicion;

- duke zvogëluar kapitalin aksionar.

Në mungesë të zgjidhjeve të mësipërme, shoqëria është e vendosur në likuidim.

15.7 - Pa cenuar dispozitat mbi tërheqjen tek shoqëritë që i nënshtrohen menaxhimit dhe koordinimit të aktivitetëve.

Neni 16 - Përjashtimi i ortakut

16.1 - Përjashtimi i një ortaku mund të ndodhë:

- për shkelje të rënda të obligimeve që dalin nga ligji ose nga kontrata e shoqërisë;



- për përjashtimin, paaftesine e ortakut ose dënimin të tij për një veprë penale që mbart përjashtimin, edhe i përkohshëm, nga zyra publike;
- për papërshtatshmëri për të kryer veprën e dhënë ose për humbjen e sendit, për shkak të arsyeve të mos atribuimit administratoreve, respektivisht, kur ortakut i ka dhënë shoqërisë veprën e vet ose gëzimin e një sendi;
- kur është i detyruar, nga kontributi, për të transferuar pronësinë e një sendi, në qoftë se ai ka humbur para se pronësia të jetë blerë nga shoqëria;
- për ushtrimin e veprimtarisë në konkurrencë me atë të shoqërisë;
- për falimentin e ortakut.

16.2 - Përjashtimi vendoset nga shumica e ortakeve, jo duke llogaritur në numrin e tyre ortakun për përjashtim, dhe do të hyjë në fuqi tridhjetë ditë nga data e komunikimit të ortakut të përjashtuar me letër rekomande me pranim marrje. Brenda këtij afati ortakut i përjashtuar mund të paraqesë ankesë para gjykatës, e cila mund të pezullojë ekzekutimin. Nëse shoqëria përbëhet nga dy ortake: përjashtimi i njërit prej tyre është dhënë nga Gjykata selise së shoqërisë, me kërkesën e tjetrit.

16.3 - Rimbursimi i kuotes të psemarrjes ndjek dispozitat e nenit 15.5 të Statutit, ku, për kushtet e rimbursimit, duhet të ndjekin rregullat në nenin 15.6; përjashtimi i ortakut, sipas nenit 2473-bis i Kodit Civil, nuk mund të bëhet duke zvogëluar kapitalin themeltar.

Neni 17 - Kompetencat e ortakeve

17.1 -Ortakeve iu rezervohen vendimet e mëposhtme:

- në çështjet e rezervuara për kompetencën e tyre me ligj ose nga statuti;
- në çështje të cilat një ose më shumë administratore i nënshtrohen miratimit;
- në çështjet që ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën një të tretën (1/3) e kapitalit aksionar i nënshtrohen miratimit të tyre.

Në çdo rast, është kompetence e ortakeve:

miratimi i pasqyrave financiare dhe ndarja e fitimeve

- emërimi, shkarkimi dhe kompensimi e anetareve të Organi Administrativ, caktimi i Kryetarit, i administratorëve të deleguar dhe përcaktimi i kompetencave dhe detyrave të tyre;

- emërimi, shkarkimi dhe kompensimi, në bazë të nenit 2477 të Kodit Civil, i Kryetareve dhe i Kryetarit të Bordit ose Auditorit

- ndryshimi i aktit të themelimit

- Vendimi për të kryer veprime që sjellin një ndryshim të konsiderueshëm të objektit të shqërisë të përcaktuar në aktin e themelimit ose ndryshimi perkates i të drejtave të ortakeve.

- 17.2 Vendimet e ortakeve mund të merren vetëm nga asambleja, në pajtim me nenin 2479-bis i Kodit Civil.

Neni 18 - Thirrja e asamblese së ortakeve

18.1 - Asambleja e ortakeve thirret nga Administratori i Vetëm ose Kryetari i Bordit, me kërkesë të ortakeve në përputhje me nenin 17.1, madje edhe jashtë selisë së shoqërisë, me

SHANIKO ALI
 NUIS LUTSOS
 PËR THARRA
 IRANI



kusht që të jetë në territorin kombëtar, me lehtë rekomande të dërguar në bancën e ortakeve së paku tetë ditë para datës së caktuar për mbledhjen, ose me çdo mjet dhe / ose sistem të komunikimit për të lejuar përgjigje të dërgimit dhe marrjes, duke përfshirë faks, e-mail dhe leter rekomande; në rastin e komunikimit me faks, postë elektronike ose mjete të tjera të ngjashme, njoftimi duhet të dërgohet, gjithmonë së paku tetë ditë para datës së caktuar për mbledhjen, me numrin e faksit, e-mail ose në adresë të veçantë të cilat janë komunikuar shprehimisht nga aksionari dhe rezultojnë shprehimisht nga regjistri i Ortakeve, nëse është krijuar, ose nga regjistri i shoqërive.

18.2- Në njoftimin e mbledhjes, do të tregohet dita, koha dhe vendi i takimit, vendi dhe lista e çështjeve që do të diskutohen. Në të njëjtin njoftim të thirrjes, gjithashtu mund të jetë vendosur dita, koha për një thirrje të mundshme të dytë, që do të mbahet brenda tridhjetë ditëve nga data e caktuar për thirrjen e parë. Njoftimi mund të kërkojë thirrje të mëtejshme, nëse edhe i dyti nuk e arrin kuorumin e nevojshëm.

18.3- Asambleja përbehet në mënyrë të vlefshme, edhe nëse nuk janë respektuar formalitetet e treguara, kur në të merr pjesë i gjithë kapitali themelues dhe të gjithë administratorët dhe auditorët ligjor, këta të fundit nëse janë caktuar, ose kur administratorët dhe auditorët të cilët nuk marrin pjesë në mbledhje kanë lëshuar një deklaratë me shkrim, mbajtur në aktet e Shoqërisë, me të cilën vërtetojnë se janë informuar për të gjitha çështjet e rendit të ditës dhe nuk kanë asnjë kundërshtim në trajtimin e tyre.

18.4 - Asambleja e ortakeve për të miratuar pasqyrat financiare duhet të mbledhet të paktën një herë në vit, në bazë të nenit 32 të Statutit.

Neni 19 - Pjesëmarrja dhe përfaqësimi

19.1- Ka të drejtë të marrë pjesë në asamble Ortaku i cili, në datën e vete asamblese, është regjistruar në regjistrin e ortakeve, nëse ka, ose që rezulton ortak nga regjistri i shoqërive. Ortaket me mosplotësim nuk mund të marrin pjesë në vendime.

19.2 - Gjithashtu lejohet pjesëmarrja në asamble me anë të mjeteve të telekomunikacionit, të tilla si mjete të telekonferencës ose videokonferencës, me kusht që:

- të gjithë pjesëmarrësit me anë të telekomunikacionit mund të jetë identifikuar nga Kryetari i Asamblese dhe Bordit;
- të gjithë ortaket mund të ndjekin diskutimin dhe të marrin pjesë në kolle reale në diskutimin e çështjeve të diskutuara;
- të gjithë ortaket mund të shkëmbejnë dokumente në lidhje me çështjet në diskutim;
- kur sa me sipër është e shënuar në procesverbal përkatës.

Në këtë rast asambleja konsiderohet e majtur në vendin në të cilin gjendet kryetari.

19.3 - Votimi mund të shprehët edhe me korrespondencë, me formular i cili duhet të kthehet në shoqëri të paktën tre ditë para datës së mbledhjes.

Ai, i cili shpreh votimin me korrespondencë konsiderohet të ketë marrë pjesë në mbledhje.

19.4 - Ortaku lirisht mund të përfaqësohet në mbledhje. Delegimi nuk mund të jetë lëshuar me emrin e përfaqësuesit në të bardhë dhe duhet të jepet për një mbledhje të vetme; kjo është gjithashtu efektive për thirrjet e mëvonshme. Rregullsia e delegimit konstatohet nga Kryetari i Asamblese.

SHANKO
NUS 16137
PËRKUPT
TRANA, 0100



19.5 - Përfaqësimi nuk mund të jepet për administratorët, kryetarët ose auditorët, punonjësit e shoqërisë, degëve të saj apo shoqërive të kontrolluara prej saj, anëtarët e organeve administrativ ose mbikëqyrës apo punonjësit e tyre.

Neni 20 - Zhvillimi i Asamblese se ortakëve

20.1 - Asambleja e Ortakeve kryesohet, në varësi të strukturës së organit administrativ, kryetari i Bordit ose nga Administratori i vetëm; në rast të mungesës së tij ose pengesë, nga personi i caktuar nga vote e shumicës së të pranishmëve.

20.2 - Kryetari asistohet nga një sekretar i emëruar nga pjesëmarrësit, të cilat mund të jetë jo-anëtarë, detyra e të cilit është që të hartojë procesverbalin.

20.3 - Kryetari verifikon përberjen e rregullt të asamblese, verifikon identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmeve, rregullon zhvillimin e mbledhjes, përcakton dhe shpall rezultatet e votimit.

20.4 - Rezolutat duhet të regjistrohen në procesverbal, duke deklaruar datën e mbledhjes; identitetin e pjesëmarrësve, edhe bashkëngjitur, dhe Kapitalin e përfaqësuar nga secili; mënyrën dhe rezultatit e votimit; identifikimin e ortakëve të favorshme, abstenues ose mospajtuës, edhe ashkëngjitur; në përmbledhje, me kërkesë të ortakëve, deklaratat e tyre përkatëse të rendit të ditës. Procesverbali duhet të nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari. Nëse rezolutat lidhen me ndryshimet në statut, raporti duhet të hartohet nga noteri.

20.5 - Procesverbali, edhe pse hartuar për akt publik duhet të transkriptohet pa vonesë në librin e vendimeve të ortakëve.

Neni 21 - Shumicat

21.1 - Ortaku ka të drejtë për një numër votash në proporcion me pjesëmarrjen e tij.

21.2 - vota duhet të shprehet në formë të qartë.

21.3 - Mbledhja përbëhet në mënyrë të rregullt me pranimë e ortakëve që përfaqësojnë pesëdhjetë për qind (50%) të kapitalit aksionar.

21.4 Asambleja, përbëre në mënyrë të rregullt në përputhje me këtë nen, vendos me shumicë absolute të Kapitali i përfaqësuar, përveç ndryshimeve në Statut, të cilat kërkojnë votën favorshme të ortakëve që përfaqësojnë shtatëdhjetë për qind (70%) të kapitalit aksionar.


Neni 22 - Organ i Administrimit

22.1 - Shoqëria mund të administrohet, në përputhje me vendimet e ortakëve:

a) nga një Administrator i vetëm;

b) nga bordi drejtues i përbërë nga dy ose më shumë drejtues, anëtarë, brenda kufijve të përmendur në paragrafin e fundit të nenit 2475 KC, mund të parashikojnë që administrimi të besohet për ta veç e veç ose bashkërisht; në raste të tilla do të zbatohen respektivisht nenet 2257 dhe 2258 të Kodit Civil.

SHOQËRIA
NË TËRËSI
PËR TËRËSI
HEANA - A.S.



22.2 - Administratorët mund të jenë jo ortake. Nuk mund të emërohet administrator dhe, nëse është emëruar, shkarkohet nga detyra i pakualifikuari, i paafiti, i paafiti për të paguar, ose ai që është dënuar me një dënim skualifikimi, edhe i përkohshëm, nga detyrat publike apo paaftësia për të ushtruar detyra drejtuese, si dhe në raste të tjera të parashikuara me ligj.

22.3 - Administratorët nuk mund të marrin pozitën e ortakeve me përgjegjësi të pakufizuar në shoqëri konkurruese apo të jenë administratore në shoqëri konkurruese, përveç nëse autorizohen nga ortaket.

22.4 - Administratori në konflikt interesi me shoqërinë, për llogari të vet ose të palëve të treta, është i detyruar të informojë shoqërinë dhe organin administrativ, nëse kolegjial, ekzistencën e konfliktit dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në rezoluta ose, në qoftë se ka përfaqësim të subjektit, të heqë dorë prej kontratave përfundimtare për të cilin ka një konflikt. Në këto raste:

- në qoftë se shoqëria menaxhohet nga Bordi Drejtues, duhet të caktohet, pas emërimit, një tjetër anëtar i organit të deleguar për të zëvendësuar përfaqësuesin në konflikt, ose ata duhet të autorizohen shprehimisht për përfundimin e kontratës;

- në qoftë se menaxhimin e shoqërisë është besuar një Administratori të vetëm, kryerja e aktit i nënshtrohet miratimit të ortakeve.

22.5 - Bordi zgjedh nga anëtarët e tij kryetarin, nëse ai nuk është i emëruar nga asambleja; gjithashtu mund të zgjedhë një Zëvendës-kryetar i cili zëvendëson kryetarin në rast të mungesës ose pengesës. Bordi Drejtues gjithashtu emëron administratorët e deleguar, duke bërë përcaktimin e kompetencave dhe detyrave.

22.6 - Bordi Drejtues bën zëvendësimin e përkohshëm të një ose më shumë administratorëve të cilët mungojnë gjatë vitit. Administratorët e emëruar në këtë mënyrë mbeten në detyrë deri në mbledhjen e parë të ortakeve të cilët do të bëjnë zëvendësimin përfundimtar. Administratorët e emëruar me këtë vendim të ortakeve mbeten në detyrë për kohën për të cilën ata duhet të mbeteshin administratorët që zëvendësohen. Megjithatë, në qoftë se shumica e Administratorëve japin dorëheqjen ose të paktën nuk është më një shumicë e Administratorëve, i gjithë bordi priset automatikisht dhe Administratorët e mbetur në detyrë do të thërrasë pa vonesë mbledhjen e ortakeve për emërimin e Bordit të ri Drejtues. Administratorët qëndrojnë në detyrë për kohë të caktuar, kur ata ishin të emëruar, ose një kohë të pacaktuar, deri në revokimin apo dorëheqjen.

22.7 - Në rast të emërimit të përhershëm deri në revokim ose shkarkim, lejohet revokimi i Administratorëve në çdo kohë dhe pa nevojën për arsye ose shkak.

22.8 - Përfundimi i afatit të administratorëve hyn në fuqi në momentin kur riformohet Bordi i ri.

Neni 23 - Vendimet e administratorëve

SHOQËRIA
NUJË 161308
PËRKITHI
TRANA 41



23.1 - Nëse shoqëria menaxhohet nga Bordi Drejtues, vendimet e saj, do të miratohen në përputhje me një nga mënyrat e mëposhtme:

- a) Me mbledhje kolegjiale;
- b) Me konsultim me shkrim prane administratorëve individuale;
- c) Në mënyrë të shprehur me shkrim nga administratorët individuale.

- Duke pasur parasysh se vendimet për:
- a) çështje për të cilën një ose më shumë administratorë bëjnë kërkesë;
 - b) përgatitja e projektit të pasqyrave financiare;
 - c) projektet e shkrirjes ose bashkimit;
 - d) vendimet për rritjen e kapitalit në pajtim me nenin 2481 Kodit Tregtar.

duhet të merren vetëm nga një mbledhje kolegjiale, kryetari i Bordit Drejtues vendos për metodën që do të miratohet nga koha në kohë,

23.2 - Për konsultim me shkrim dhe pëlqimin me shkrim, duhet të përgatitet një dokument i veçantë që duhet të evidentojë:

- a) çështja objekt vendimit;
- b) aspektet pozitive dhe eventualisht negative që mund të sjellë vendimi;
- c) datën në të cilën vendimi duhet të synohet i miratuar, ku duhet të kuptohet si ajo në të cilën merret mendimi që lejon të arrihet kuorumi i nevojshëm për marrjen e vendimit;
- d) mendim shprehur nga Administratori dhe, eventualisht, motivin që mbështet këtë mendim;
- e) nënshkrimin e Administratorit.

23.3 - Çdo administrator duhet të marrë një kopje të atij dokumenti, i cili, nga ana tjetër, duhet të kthehet në shoqëri brenda tri ditëve pasi ka shprehur votën e tyre pro ose kundër ose abstenim, duke treguar, kur është e përshatshme, arsyen për kundërshtimin apo abstenimin, dhe të kene nënshtuar. Dështimi për të kthyer dokumentin duhet të interpretohet si një votë kundër.

23.4 - Konsultimi me shkrim ose pëlqimin me shkrim mund të bëhet me postë të regjistruar me pranimin e kthimit, ose me çdo mjet dhe / ose sistem të komunikimit që lejon për një përgjigje të dërgesës dhe pranimin, duke përfshirë faks, e-mail dhe letër rekomande me dorë. Në rastin e komunikimit me faks, postë elektronike ose mjete të tjera të ngjashme, njoftimi duhet të dërgohet në një numër fax, e mail ose numrin e veçantë që i është komunikuar shprehimisht nga Administratori; nënshkrimi i dokumenteve mund të bëhet në mënyrë dixhitale.

23.5 - Rezultatet e konsultimit me shkrim ose pëlqimi me shkrim duhet t'i komunikohet administratorëve dhe auditorëve, nëse janë emëruar, duke shënuar emrat e administratorëve të favorizuar, ata kundër dhe ata që abstenuan.



23.6 - Çdo konsultim me shkrim ose pëlqim me shkrim duhet të shënohet, pa vonesë, në librin e vendimeve të administratoreve, duke referuar gjithashtu:

- a) emrat e administratoreve pro, ata kundër dhe ata që abstenuan;
- b) një deklaratë që secili administrator dëshiron që të transkriptohet në procesverbal;
- c) nënshkrimin e Kryetarit të Bordit;

ndërkohë që duhet të mbahen dokumentet e nënshkruara nga administratorët.

23.7 - Në rastin e mbledhjes kolegjiale, Bordi Drejtues, së bashku me Kolegjin sindakal apo auditor, qoftë i emëruar, do të thirret nga kryetari, me kërkesë të një drejtori, sipas njoftimit të dërguar nga pikat postare ekspres postë me pranimin e kthimit, ose me çdo mjet dhe / ose të sistemit të komunikimit për të lejuar një krahasim të dërgesës dhe pranimit, duke përfshirë faks, e-mail dhe leter rekomande me dorë. Në rastin e thirrjes me faks, postë elektronike ose mjete të tjera të ngjashme, njoftimi duhet të dërgohet në një numër fax, e-mail ose në një numër specifik që është komunikuar shprehimisht nga administratori dhe kryetari apo auditori, nëse emëruar, të paktën tre ditë para mbledhjes dhe, në raste urgjente, me telegram ose me faks dërguar të paktën një ditë më parë, ku të jenë caktuar data, ora dhe vendi i mbledhjes, madje edhe jashtë zyrës së regjistruar, si dhe rendi i ditës.

23.8 - Bordi Drejtues, megjithatë, përbëre në mënyrë të vlefshme, madje edhe në rastin kur nuk janë respektuar formalitetet e sipërpërmendura, me kusht që të jetë përfaqësuar i gjithë Bordi Drejtues, i gjithë kolegji sindakal ose Auditori, nëse është emëruar, dhe askush nuk kundërshton diskutimin e çështjeve.

23.9 - Mbledhjet e Bordit, nëse Kryetari konkludon domosdoshmërinë mund të mbahen në mënyrë të vlefshme nga video apo audio konferencë, me kusht që:

- a) të gjithë pjesëmarrësit me anë të mjeteve të telekomunikacionit mund të identifikohen nga të gjithë administratorët e tjerë;
- b) të gjithë administratorët mund të ndjekin diskutimin dhe të marrin pjesë në kohë reale në diskutimet;
- c) të gjithë administratorët mund të shkëmbejnë dokumente në lidhje me çështjet në diskutim;
- d) sa më sipër regjistrohen në procesverbal përkatës.

Në këtë rast asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku është i vendosur kryetari.

23.10- Bordi Drejtues do të jetë i vlefshëm, në formë kolegjiale, me praninë e shumicës së ortakeve të tij në detyrë dhe do të jetë efektiv me shumicën absolute të votave të të pranishmeve. Në rast të një barazimi, propozimi vlerësohet i refuzuar. Përfshihet votimi me prokurë.

23.11 - Çdo rezolutë e Bordit do të regjistrohet pa vonesë në librin e vendimeve të administratoreve dhe të nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari.

SHANKO ADEM
NUIŠ 1613280181
PERKTHIME
PRANA - ALBAHA



Neni 24 - Kompetencat e administratoreve

24.1 - Organi qeverisës është i veshur me kompetenca të plota për të menaxhuar shoqërië, duke u deleguar, ekskluzivisht, përgjegjësi për menaxhimin e shoqërië dhe përmbushjen e çfarëdo veprimi që konsideron të arsyeshëm për përmbushjen e objektit të shoqërië. Prandaj ka të drejtë për të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, me përjashtim të atyre që ligji apo ky statut rezervojnë shprehimisht për ortaket.

24.2 - Në çdo rast, i perket organit administrativ emërimi, përcaktimi i kompetencave për: Administratoret, drejtorët e përgjithshëm, zëvendësuesit ose përfaqësuesit për kryerjen e akteve të caktuara apo kategorive të akteve.

24.3 - Në rastin e emërimit të Bordit Drejtues, ai mund të delegojë disa nga kompetencat e tij, edhe veç e veç, në përputhje me kufijtë e nenit 2381 cc. Kryetari, një Komiteti Ekzekutiv i përbërë nga disa prej ortakeve të tij apo administratoreve të deleguar, Kryetari, Komiteti Ekzekutiv ose Administratori ose administratoret e deleguar mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, të cilat rezultojnë nga kompetencat e deleguara nga Bordi Drejtues, me kufizimet dhe modalitetet e përcaktuara në delegim.

24.4 - Bordi Drejtues mund të japë udhëzime për organet e deleguara dhe të sugjerojë për ta operacionet e reregjistruara në delegim. Nuk mund të delegohen: përgatitja e pasqyrave financiare, kompetenca e dhënë nga ortaket Bordit Drejtues për rritjen e kapitalit aksionar, rivendosjen e kapitalit për humbjet, zvogëlimin e kapitalit për humbjet, vendimet për bashkimin dhe shpërberjen. Çdo administrator mund të kërkojë nga organet e deleguara për të siguruar Bordit informacion lidhur me menaxhimin e shoqërië dhe të kundërshtojnë operacionin që Kryetari dhe administratoret e deleguar deshirojnë të përmbushin para se të realizohet. Në kërkesat dhe kundërshtimet e tilla vendos Bordi Drejtues.

Neni 25 - Përfaqësimi i shoqërisë

25.1 - Përfaqësimi ligjor i shoqërisë dhe firma e shoqërië i perket Kryetarit të Bordit Drejtues ose Administratorit të vetëm, ose keshilltareve të deleguar në kufijtë e delegimit, duke vepruar bashkërisht ose veçmas, në varësi të faktit nëse kompetencat e administrimit, pas emërimit, të jenë caktuar për ta bashkërisht ose veçmas.

Neni 26 - Shpërblimi i administratoreve

26.1 - Administratorëve iu njihet rimbursimi i shpenzimeve të bëra për vitin ushtrimor e detyrave të tyre. Ortaket përcaktojnë pagesën totale vjetore, duke përlshirë edhe në formën e pjesëmarrjes në fitime, i caktohet Organit Administrativ, i cili, nga ana tjetër, përcakton mënyrat e shpërndarjes së saj ndërmjet anetareve individuale.

SHANKO ADRIAN
NUM 1613280183
PERKTHIME
TRANA, ALBANIA



26.2 - Administratoreve iu njihet shpërblimi i përfundimit të mandatit, që do të ngrihet përmes ndarjeve vjetore apo nga polica të veçanta të sigurimit.

Neni 27 - Organi i Kontrollit

27.1 - Shoqëria është e kontrolluar nga një bord i auditorëve vetëm nëse verifikohen kërkesat ligjore të nenit. 2477 cc, ky Bord është i përbërë nga tre auditorë dhe dy zëvendës të emëruar nga Asambleja e Ortakeve, e cila gjithashtu cakton Kryetarin dhe përcakton shpërblimin e tyre për periudhën. Ata qëndrojnë në detyrë për tre vjet, rizgjidhen dhe përfundojnë në datën e vendimit të ortakeve të miratimit të pasqyrave financiare për vitin e tretë në detyrë.

Neni 28 - Bordi i Auditorëve

28.1 - Bordi i Auditorëve i kërkohet të përgatisë procesverbalin e çdo mbledhjeje në Librin e vendimeve Mbikëqyrëse Bordit; ai duhet të nënshkruhet nga pjesëmarrësit. Rezolutat e bordit mbikëqyrës merren me shumicë absolute të të pranishmëve.

28.2 - Shpërblimi vjetor i auditorëve është i përcaktuar nga ortaket në aktin e emërimit për të gjithë mandatin e tyre.

28.3 - Auditorët duhet të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë së ortakeve, mbledhjet e Bordit Drejtues dhe mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv.

28.4 - Kontrolli i Bordit, kur Organi i Kontrollit nuk është i detyrueshem për Kodin Civil, duke përfshirë auditimin e llogarive dhe auditimin e performancës.

Neni 29 - Auditor

29.1 - Kur nuk është i detyrueshem emërimi i Bordit të auditorëve, në pajtim me nenin 2477 i Kodit Civil, kontrolli i shoqërisë mund të ushtrohet nga një auditor.

29.2 - Nuk mund të merret persiper mandati i auditorit dhe, nëse është emëruar, shkarkohet nga detyra ai që gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 2399 cc

29.3 - Mandati zgjat tre vjet, me skadim në datën e vendimit të ortakeve të tre viteve të fundit të miratimit të pasqyrave financiare.

29.4 - Auditori kryen kontrollin e kontabilitetit në përputhje me funksionet dhe karakteristikat e përmendura në nenet 2409-ter - f 2409-CC, në përputhje me përbërje monokrafike figura që mbulon dhe dispozitat e këtij statuti.

29.5 - Shpërblimi i Auditorit përcaktohet nga ortaket në aktin e emërimit për të gjithë periudhën e kohezgjatjes së detyrës së tij.

29.6 - Mandati mund të revokohet pa arsye me vendim të ortakeve, që do të merret nga një shumicë e gjashtëdhjetë për qind të kapitalit aksionar.

SHANIKO ALAMI
NUS LAIBANI
PERKIN
1980

Neni 30 - Kontrolli i ortakëve

30.1 - Ortaket të cilët nuk marrin pjesë në administrim kanë të drejtë të kenë nga administratorët, në pajtim me nenin 2476 cc, njoftime mbi kryerjen e punëve të shoqërisë dhe për t'u konsultuar, madje edhe nga profesionistë të besimit të tyre, librat dhe dokumentet që kanë të bëjnë me administrimin e shoqërisë.

Neni 31 - Vitet financiare

31.1 - Viti fiskal fillon nga 1 janari deri më 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 32 - Pasqyrat financiare

32.1 - Në fund të çdo viti financiar të shoqërisë Organi administrativ kujdeset për ndertimin e pasqyrave financiare dhe formalitetet ligjore që rezultojnë.

32.2 - Pasqyrat financiare duhet të miratohen nga ortakët brenda 120 ditëve nga mbyllja e vitit financiar, ose brenda 180 ditësh në rastin në të cilin shoqërisë i kërkohet të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara ose kur, për shkak të strukturës së veçantë në të cilën është e ndarë shoqëria dhe për kryerjen e aktiviteteve të përcaktuara në objektin e shoqërisë kërkon nevoja të veçanta; në këto raste, administratorët duhet të raportojnë, në raportin e tyre, ose në shënimet shpjeguese në rastin e pasqyrave financiare të përgatitura në formë të shkurtuar, për arsyet e vonesës.

Neni 33 - Ndarja e fitimeve

33.1 - Vendimi i ortakëve që miraton pasqyrat financiare do të vendosë për shpërndarjen e fitimeve.

33.2 - Në pajtim me nenin 2430 cc, nga fitimet neto që rezultojnë në pasqyrat financiare duhet të zbritet një shumë e barabartë me pesë për qind (5%) në rezervën ligjore deri sa të arrijë një të pestën e kapitalit.

33.3 - për të shpërndarë paratë në fitimet nuk lejohet

Neni 34 - Shpërbërja dhe likuidimi

34.1 - Shpërbërja vullnetare e shoqërisë miratohet nga Asambleja e Ortakëve me shumicën e parashikuar për ndryshimin e këtij statuti.

34.2 - aplikohen të gjitha dispozitat e nënveve. 2484 - 2496 cc

Neni 35 - klauzolë arbitrazhi



35.1 - Çdo mosmarrëveshje që lind nga marrëdhëniet e shoqërisë që mund të lindin ndërmjet ortakëve dhe / ose ndërmjet tyre dhe shoqërisë objekti i të cilave janë të drejtat në dispozicion në lidhje me marrëdhëniet e shoqërisë, me përjashtim të atyre në të cilën ligji parashikon ndërhyrjen e detyrueshme të prokurorit publik, madje edhe kundrejt administratoreve, auditorëve dhe likuidimit, duke përfshirë ato që lidhen me vlefshmërinë e rezolutave të ortakëve, ajo do të referohet një arbitri të vetëm i cili do të vendosë në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenet 34-35-36 DL 17/01/2003 n. 5. Sipas këtij ligji arbitri do të emërohet nga Kryetari i Gjykatës, ku ka selinë shoqëria.
Në çdo rast, arbitri do të vendosë në bazë të ligjit.

Neni 36 - Rregulloret përfundimtare

36.1 - për gjithëka të paparashikuar në këtë statut, i referohet ligjit kohor në fuqi në atë kohë.

Nënshkruar Manganaro Ninfa

Maurizio Savio - vijon vula



SANPAOLO BANKA E NAPOLI

DERDIJË NJEQIND PËR QIND E KAPITALIT THEMELTAR

SHOQËRI NE THEMELIM ASI-COMI SRL,

SHERBIME INVESTIGIMI

Kapitali në të holla 10.000(dhjetë mijë/00) Euro

ZOË MANGANARO NINFA

lindur në Napoli, më 24 nëntor 1968

banues në adresën: via Figurelle n. 52 Napoli

ka dërdhur pranë kësaj dege për llogari të ortakëve të nënshkruar të shoqërisë së mesipërme në bazë dhe për efektet e nënit

2361 cc (për themelimin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar)

Shumen e poshteshënuar, që përfaqëson 100% të kapitalit të mesipërm.

Ortakët nënshkruar

| Mbëmbri e catri | Vendi dhe data e lindjes | Shtetësia | Banimi | Kuota e pjesëmarrjes |
|-----------------|--------------------------|-----------|---------------------|----------------------|
| MANGANARO NINFA | Napoli, 24 nëntor 1968 | Italiene | via Figurelle n. 52 | 100% |

Shuma e dërdhur 10.000(dhjetë mijë/00) Euro

Firma, vula e Bankës



Rep. Nr. 2612

Une Dr. Maurizio Savio, noter në Napoli me zyre në Via San Carlo 16, regjistruar në Kolegjin e Noterëve të rrethëve të Napolit, Torre Annunziata dhe Nola, vërtetohet se kjo fotokopje, e përbërë nga një (no 1.) faqe me shkrim, është e njëjte me origjinalin e dokumentit paraqitur nga kerkuesi Znj. Ninfà MANGANARO, lindur në Napoli me 24 nëntor 1968 dhe banues në via Figurelle n. 52, për identitetin personal e të cilit unë Noteri u sigurova, dhe kthyer perseri dokumenti asaj.

Napoli, 3 maj 2010

Nënshkruar Maurizio Savio - vijon vula

Unë dr. Maurizio Savio, noter në Napoli, vërtetohet se kjo fotokopje, e përbërë nga tetëmbëdhjetë (18) fletë me shkrim nga tridhjetë e pesë faqe (35), është e njëjte me origjinalin në aktet e mia.

Leshuar në loter të thjeshtë për përdorimet e lejuara nga ligji.

Napoli, 16 maj 2010

Nënshkrini, vula

SHANIKO ALI
NUIŠ 1618280
PERKIN
10/05/2010

APOSTILLE

(Konventa e Hagës e Tetorit 1961)

SHITETI ITALI

Ky akt publik u firmos nga Z. SAVIO MAURIZIO

me cilesine e Noterit

me vulen e Zyres

VERIFIKOHET

Në NAPOLI me date 31 MAJ 2017

nga Prokuroria e Republikës NAPOLI, SEKSIONI I PUNEVE CIVILE

me Nr. 1839/17,

Firma, vula

(emër, mbiemër, firma vula)



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 2264 REP.



VERTETIM

Sot ne Tirane, para meje Noterit, vertetohet firma e perkthyeses Shaniko Ademi, me NIPT L61328018J, njohur personalisht prej meje Noterit, e cila deklaroi se perktheu sa me siper nga gjuha Italiane ne gjuhen Shqipe dhe nenshkroi rregullisht ne pranine time. Une Noteri vertetoi nenshkrimin e saj.

Tirane, me 03 / 07 / 2017

NOTER